



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



## KONTRATË

Numri i kontratës<sup>1</sup>: 616-24-4096-2-2-1/C1477

**KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES** (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëzën anë; dhe  
**D&D Business Support Center L.L.C., EDIT DURHAM HI NR.11, PRISHTINË, 811374462**, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

**Përpilimi i strategjisë për agro turizëm dhe ngritje kapacitetesh me numër identifikues: 616-24-4096-2-2-1**

### **Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është përformimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

**Përpilimi i strategjisë për agro turizëm dhe ngritje kapacitetesh sipas përshkrimit teknik të dhënë në dosjen e tenderit**

Nr.	616-24-4096-2-2-1
1	Përpilimi i strategjisë për agro turizëm dhe ngritje kapacitetesh

### **Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **11,700.00 €**; [Njëmbëdhjete mijë e shtatëqind euro e zero eurocent].

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

#### Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.





4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në kater origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

#### Për Autoritetin Kontraktues

#### Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Visar Shehu	Emri:	SAFET FAZLIU
Pozita:	Zyrtar PP i Prokurimit Publik	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	06.06.2024	Data:	06.06.2024
Vula:		Vula:	

# KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 616-24-4096-2-2-1/C1477

## Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 **"Shërbimet"** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **"Ofruesi i shërbimeve"** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **"Personeli"** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë shumën e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **"Nënkontraktuesi"** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **"Palë"** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **"Autoriteti Kontraktues"** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **"KPK"** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

2.1 KVK e saktësojnë cilin është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

## Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura

Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshëm.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njih lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

## **Neni 5 Tatimet dhe Doganat**

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

## **Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve**

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një datë tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrin me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

## **Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit**

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

## Neni 8

### Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

## Neni 9

### Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndër marrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

## **Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve**

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafitë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

## **Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve**

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimin për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veprojë në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i pafektishëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbsisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

## **Neni 12 Obligimet e Autoriteti Kontraktues**

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkojë në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

## **Neni 13 Dëmet e likuiduara**

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguajë dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkalojë shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikojë në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

## **Neni 14 Siguria e ekzekutimit**

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizojë Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdojë të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

## **Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve**

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marrë dhe do të ruajë, dhe do të shkaktojë Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofrojë dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

## **Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës**

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

16.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrë të duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

#### **Neni 17            Kontrolli i kualitetit**

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

#### **Neni 18            Korrigjimi i defekteve**

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

#### **Neni 19            Konsekuencat e Shkeljes se kontratës**

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### **Neni 20            Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.



## **Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

## **Neni 22 Dëmshpërblimi**

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë asemi të siguar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

## KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 616-24-4096-2-2-1/C1477

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante.]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është nga data e caktuar ne planin e menaxhimit nga menaxheret e kontratës
	6.4	Data e Përfundimit është <b>120 dite</b> .
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve ne Prishtinë
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është caktohet me vendim nga ZKA
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25% e Çmimit final të Kontratës në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është <b>10% e vlerës së përfertës ne afat prej 150 ditëve</b>
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Pagesa do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktues për shërbimet e kryera pas përfundimit te kryerjes se shërbime me konstatim nga menaxheri i kontratës dhe organi mbikëqyrës për shërbimet e kryera
Kontrolli i kualitetit	17.1	AK do ta inspektoj OE gjate gjithë kohës se kryerjes se shërbimeve
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve te cilat mund te lindin gjatë ekzekutimit se kësaj kontrate dhe se është e mundur te zgjidhet ne mënyrë miqësore, përgjegjës për zgjidhjen e tyre do të jenë personat përgjegjës të Autoritetit Kontraktues dhe personat përgjegjës të kontraktuesit.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën komerciale -në Prishtinë.

# ANEks 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

## Strategjia e Agroturizmit në Kryeqytetin Prishtina

<b>1. Historiku</b>	<p>Kryeqyteti Prishtina ka një sipërfaqe rreth 572 km<sup>2</sup> dhe ka afërsisht 200,000 banorë (Regjistrimi i popullësisë nga ASK 2011). Ndërsa, ky numer është parashikuar të rritet në mbi 400,000 banorë nga viti 2011 deri në vitin 2021 sipas (ASK). Prishtina përveç se është kryeqytet njëkohësisht është edhe qyteti më i madh në Republikën e Kosovës, dhe shtrihet në pjesën verilindore të Kosovës, afër maleve të Gollakut, ku distanca mes Shkupit dhe Prishtinës është 90 km, me Tiranën ka distancë 250 km, dhe 300 km me Podgoricën.</p> <p>Kryeqyteti është i pasur me trashëgimi kulturore dhe historike. Ndërsa, agroturizmi ka një potencial të madh të zhvillimit ekonomik dhe njihet si një industri e re zhvillimore. Në kryeqytet përveç pjeses urbane ku gjendet trashëgimia kulturore dhe historike, edhe në fshatrat e saj posedon potenciale të mëdha të agroturizmit, turizmin rural, malor dhe ekoturizmit. Me kalimin e kohës kryeqyteti ka njohur potencialin zhvillimor të agroturizmit si një mënyrë për të nxitur ekonominë lokale. Qendrimet në ferma bujqësore dhe përvoja nga ferma në tavolinë u bënë të njohura pasi që kryeqyteti Prishtina është destinacioni më i kërkuar nga turistët vendor dhe ndërkombëtar.</p> <p>Shpirti dinamik që e ofron kryeqyteti dhe veçantitë natyrore përreth fshatrave, e bëjnë atë një nga destinacionet kryesore të turizmit në nivel vendi dhe më një potencial të madh të zhvillimit ekonomik. Agroturizmi është ende në fazat e para të zhvillimit ndërsa më këtë strategji synohet ti jepet kahje zhvillimit.</p>
<b>1.1. Institucioni përfitues</b>	Kryeqyteti Prishtina
<b>Objektivat dhe Rezultatet e Pritura</b>	
<b>2.1. Objektivat e përgjithshme</b>	<p>Objektivi i përgjithshëm i strategjisë së agroturizmit është promovimi dhe zhvillimi i sektorit bujqësor, duke ofruar komunës së Prishtinës kornizën e nevojshme për zhvillim efektiv dhe të qëndrueshëm të agroturizmit. Strategjia synon të shfaqë burimet unike bujqësore, trashëgiminë rurale dhe bukurinë natyrore të të gjitha fshatrave të Prishtinës, duke krijuar mundësi për fermerët të diversifikojnë të ardhurat e tyre dhe që vizitorët të përshihen në përvoja autentike rurale. Strategjia synon të nxisë rritjen ekonomike, të ruajë mjedisin dhe të forcojë lidhjen midis komuniteteve urbane dhe rurale.</p>
<b>2.2. Objektivat specifike</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Promovimi i praktikave të qëndrueshme bujqësore dhe ruajtjes së mjedisit;</li><li>2. Rritja e ekonomisë lokale duke gjeneruar të ardhura shtesë për fermerët dhe komunitetet rurale;</li><li>3. Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë rurale të Komunës;</li></ol>
	4. Rritja e ndërgjegjësimit dhe vlerësimit për produktet bujqësore lokale dhe

	<p>përfitimet e tyre;</p> <p>5.Nxitja e partneriteteve midis fermerëve, bizneseve lokale dhe organizatave turistike për të krijuar një rrjet të fortë agroturizmi;</p> <p>6.Zhvillimi i infrastrukturës dhe komoditeteve për të mbështetur aktivitetet agroturistike të tilla si qëndrimet në ferma ose turne me guidë;</p> <p>7.Inkurajimi i përfshirjes dhe angazhimit të komunitetit në nismat e agroturizmit.</p>
<p>2.3. Rrezultatet që duhet të arrihen nga Ekipit të Konsulentëve</p>	<p>Ekipi i konsulentve në hartimin e strategjisë së agroturizmit synon të arrijë disa rezultate duke përfshirë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Përgatitja e strategjisë zhvillimore të agroturizmit me faza për të gjitha fshatrat e kryeqytetit duke identifikuar zonat kryesore agroturistike me prioritet brenda saj;</li> <li>2.Zbatohet një program zhvillimi institucional dhe një program për ngritjen e kapaciteteve;</li> <li>3. Identifikimi resursve natyrore, potencialit bujqësore dhe blegtoral në fshatrat me potencial të lartë të zhvillimit të agroturizmit;</li> <li>4.Rritja e të ardhurave dhe përfitimit për bizneset bujqësore të përfshira në agroturizëm;</li> <li>5.Diversifikimi i burimeve të të ardhurave për fermerët, duke nxitur praktikat tradicionale bujqësore;</li> <li>6.Krijimi i mundësive të punësimit në sektorin e agroturizmit, në dobi të fermerëve dhe komunitetit lokal;</li> <li>7.Përmirësimi i aksesit në treg dhe i dukshmërisë për produktet bujqësore duke çuar në rritjen e shitjeve dhe pjesës së tregut;</li> <li>8.Rritja e njohjes dhe reputacionit të markës për bizneset lokale, duke i pozicionuar ata si lider në agroturizëm;</li> <li>9.Ndikim pozitiv ekonomik në ekonominë lokale, nëpërmjet rritjes së shpenzimeve turistike dhe efekteve shumëfishuese;</li> <li>10. Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë rurale lokale, duke kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm të rajonit.</li> </ol>
<p>3.Përshkrimi i Projektit</p>	<p>Projekti ka për qëllim zhvillimin e strategjisë së agroturizmit duke marrë parasysh se turizmi sot paraqitet si një nga industritë më të fuqishme e cila ka një ndikim shumë të madh në zhvillimin socio-ekonomik, sidomos të vendeve në zhvillim siç është vendi ynë Kosova. Agroturizmi mund të vlerësohet si një nga burimet më të rëndësishme të të ardhurave për komunitetin që jeton në zonat rurale, ndihmon në krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe në mbrojtjen e mjedisit.</p> <p>Strategjia e agroturizmit është një projekt shumë i rëndësishëm që synon të promovojë dhe zhvillojë sektorin e bujqësisë në kryeqytet duke tërhequr</p>

	<p>turistë dhe duke krijuar një industri të qëndrueshme turistike. Në këtë strategji duhet të shfaqen burimet unike bujqësore, trashëgiminë rurale dhe bukurinë natyrore të zonës së kryeqytetit, duke krijuar mundësi për fermerët që të diversifikojnë të ardhurat e tyre dhe që vizitorët të përjetojnë jetën autentike rurale. Nëpërmjet kësaj strategjie, duhet të nxisim ekonominë lokale, të ruajmë mjedisin dhe të forcojmë lidhjen midis komuniteteve urbane dhe rurale, strategjia duhet të kontribuojë në zhvillimin e përgjithshëm.</p> <p>Kryeqyteti Prishtina ka potencial për zhvillimin e agroturizmit në zonat rurale pasi që ka të rregulluar infrastukturën si një nga elementet kryesore për implementimin e projekteve.</p>
<p>3.1. Gjenerale</p>	<p>Strategjia duhet t'i sigurojë kryeqytetit një platformë koordinuese për zhvillimin e veprimit të agroturizmit në të gjitha fshatrat. Strategjia duhet të ndërtohet përmes zbatimit të aktiviteteve të mëposhtme:</p> <p>➤ <b>Vlerësimi i situatës aktuale:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Analiza e kornizës institucionale dhe ligjore, rregullatore dhe politike;</li> <li>- Vlerësimi i kërkesës dhe mundësive për zhvillimin e zonës së destinacionit turistik;</li> <li>- Vlerësimi i kushteve në bazë të planeve hapësinore, boshllëqeve të infrastrukturës dhe atraksioneve dhe objekteve të vizitorëve;</li> <li>- Vlerësimi i mundësive dhe kufizimeve mjedisore, sociale, socio-ekonomike dhe të trashëgimisë rurale;</li> </ul> <p>➤ <b>Caktimi i objektivave bazë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillimi i projeksioneve të rritjes së agroturizmit dhe skenarëve të zhvillimit;</li> <li>- Hartimi i strategjisë së agroturizmit të integruar; dhe</li> <li>- Finalizimi përmes angazhimit aktiv të palëve të interesuara.</li> </ul>
<p>4. Përgjegjësitë dhe Detyrat e Ekipit të Konsulentëve</p>	<p>Përgjegjësitë dhe detyrat e Ekipit të Konsulentëve përfshijnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Kryerja e kërkimit:</b> Ekipi duhet të mbledhë të dhëna dhe të kryen kërkime për të kuptuar sektorët e bujqësisë, tendencat e turizmit dhe kërkesat e vizitorëve/turisteve. Ky informacion ndihmon në formulimin e një strategjie efektive.</li> <li>2. <b>Identifikimi i mundësive:</b> Ekipi, identifikon mundësitë për zhvillimin e agroturizmit, të tilla si produktet unike lokale, trashëgiminë rurale ose atraksione natyrore. Kjo ndihmon në krijimin e përvojave tërheqëse për turistët.</li> <li>3. <b>Bashkëpunimi me palët e interesuara:</b> Ekipi, punon ngushtë me fermerët, bizneset lokale, organizatat turistike dhe agjencitë qeveritare për të mbledhur të dhëna, për të ndërtuar partneritete dhe për të siguruar një qasje të koordinuar për zbatimin e strategjisë.</li> <li>4. <b>Zhvillimi i aktiviteteve të marketingut dhe promovimit:</b> Këto, kontribuojnë në hartimin e fushatave të marketingut dhe materialeve promovuese për të tërhequr turistët në ofertat e agroturizmit. Kjo mund të përfshijë krijimin e faqeve të internetit, fushatat e mediave sociale ose</li> </ol>

	<p>organizimin e ngjarjeve në zonat rurale.</p> <p><b>5. Ofrimi i analizave financiare:</b> Ekipi, vlerëson qëndrueshmërinë financiare të projekteve të agroturizmit duke përfshirë vlerësimin e kostos, parashikimet e të ardhurave dhe analizën e kthimit nga investimi. Kjo ndihmon në marrjen e vendimeve të informuara dhe sigurimin e fondeve.</p> <p><b>6. Monitorimi dhe vlerësimi:</b> Bën gjurmimin e ecurisë të strategjisë së agroturizmit, mbledhin komente dhe vlerësojnë efektivitetin e saj. Kjo lejon që rregullimet dhe përmirësimet të bëhen me kalimin e kohës.</p> <p>Përgjegjësitë dhe detyrat specifike mund të ndryshojnë në varësi të kontekstit dhe fushëveprimit të strategjisë së agroturizmit.</p>
4.1. Zyret, dhe mbështetja	<p>Autoriteti kontraktues nuk do të ofrojë zyrë dhe pajisje për nevojat e Ekipit të Konsulentëve.</p> <p>Autoriteti kontraktor do të sigurojë një menaxher të dedikuar të projektit për të vepruar si pikë kontakti nëpërmjet Ekipit të Konsulentëve dhe Njësisë Kërkuese.</p>
4.2. Mjetet të cilat duhet të sigurohen nga Ekipi i Konsulentëve	<p>Ekipi i Konsulentëve do të sigurojë ekspertizë për të realizuar strategjinë e agroturizmit në mënyrë profesionale dhe duhet të jenë të pajisur me mjetet e nevojshme të punës.</p>
4.3. Pajisjet	<p>Të gjitha pajisjet dhe mjetet e nevojshme për hartimin e strategjisë së agroturizmit për të arritur rezultatet e synuara duhet të sigurohen nga OE pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.</p>
4.4. Shpenzimet e rastit	<p>Provizionet për shpenzimet e rastësishme mbulohen nga Ekipi i Konsulentëve në kuadër të Kontratës.</p>
<b>5. Raportet</b>	
5.1. Kërkesat e raportimit	<p>Gjatë hartimit të strategjisë së agroturizmit duhet të dorëzohen këto raporte; Raporti fillestar, Raporti i ndërmjetëm dhe Raporti Përfundimtar.</p> <p><b>Afati kohor:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pas 1 muaji, duhet të prezantohet gjetjet fillestare;</li> <li>- Pas 3 muajve, duhet të prezantohet drafti i raportit;</li> <li>- Pas 4 muajve, duhet të prezantohet raporti përfundimtar i strategjisë së agroturizmit.</li> </ul>
5.2. Dorëzimi dhe aprovimi i raporteve	<p>Kopjet e raporteve të përmendura më sipër duhet t'i dorëzohen Menaxherit të Projektit të identifikuar në Kontratë. Dokumentet duhet të jenë të shkruara në shqip dhe anglisht. Menaxheri i projektit është personi përgjegjës për miratimin e raporteve.</p>

Monitorimi dhe Vlerësimi i Projektit bëhen nga Menaxheri i Projektit dhe Organi Mbikëqyrës i Projektit.

➤ **DORËZIMI I DOKUMENTIT TË STRATEGJISË SË AGROTURIZMIT**

Pas miratimit nga Njësia Kërkuese të draftit përfundimtar, duhet të dorëzohen tre (3) kopje fizike dhe 1 kopje digjitale (Word dhe PDF).

➤ **AFATI I PËRFUNDIMT**

Hartimi i Strategjisë së Agroturizmit duhet të përfundojë brenda 120 ditëve kalendarike.

## Pjesa e II-te përshkrimi i çmimit

### Përpilimi i strategjisë për argotizëm dhe ngritje kapacitetesh

Nr.	Pershkrimi i artikullit	Njesia	Sasia	Çmimi me TVSH	Totali Me TVSH
1.	Përpilimi i strategjisë për argotizëm dhe ngritje kapacitetesh sipas specifikimit teknik – Aneksit 1	copë	1	11,700,00 €	11,700,00 €
				Totali	11,700,00 €

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	D&D BUSINESS SUPPORT CENTER
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TE OE:	SAFET FAZLIU
NËNSHKRIMI:	
DATA:	15.05.2024
VULA:	

